



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1913/1 Prot.

Durrës, më 24.7.2026

V E N D I M

Nr. 118, datë 24.7.2026

PËR

**"NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 8, DATË 10.02.2025 TË SENATIT AKADEMIK
"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR CIKLIN E
PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL 2-VJEÇAR, PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE, CIKLIN E
DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL,
PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU",
DURRËS".**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 74 & 76; VKM Nr. 407 datë 01.06.2016 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim", i ndryshuar, në Urdhërin e Ministrisë së Arsimit nr. 394, datë 24.07.2026 "Për hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Accounting" në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës me Institutin Politeknik të Bragancës, Portugali"; në Vendimin nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik, në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 115, datë 20.07.2026; në propozimin e kriterëve të pranimit nga Fakulteti i Biznesit, si dhe në shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 1761/3 Prot, datë 24.07.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në pikën 1 (një) të Vendimit nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik, për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e ri të studimit, të ciklit të parë, Bachelor në "Accounting", i cili do të ofrohet pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit, të Fakultetit të Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, për vitin akademik 2026-2027, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim i bashkëlidhet dhe është pjesë e pandashme e Vendimit nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik.
3. Për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit të Biznesit
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI



KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR

FAKULTETI I BIZNESIT

Cikli i studimeve	Programi	Kriteret e pranimit
Bachelor	"Accounting" (program i përbashkët me "Institutin Politeknik të Bragançës", Portugali)	<i>Si kriter përjashtues</i> Të zbatohet vendimi i Qeverisë në lidhje me përcaktimin e kufirit të notës mesatare. <i>Si kriter përzgjedhës të pranimit të studentëve:</i> Maturantët do të vlerësohen sipas notës mesatare në rend zbritës. (nota mesatare 50% mesatarja e të gjitha lëndëve + 50% provimet e maturës shtetërore). Për aplikantët që vijnë nga Shkollat Profesionale Ekonomike, do të aplikohet koeficienti 1.2.

